



# vullnetarizmi • AL

Platforma dixhitale e  
vullnetarizmit në Shqipëri

## NJOHJA DHE NËJTJA E VULLNETARIZMIT NË SHQIPËRI PËRMES PËRMIRËSIMIT TË KUADRIT LIGJOR EKZISTUES

▶ LETËR POLITIKE

**PERTEJ BARRIERAVE**  
Ne besojmë në atë që bëjmë


**PN**  
Projekte Vullnetare Ndërkombëtare

**CPD  
QPZH**

Financuar nga LevizAlbania

**LEVIZ  
Albania**  
Local Democracy in Action

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për  
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC



**NJOHJA DHE NXITJA E  
VULLNETARIZMIT NË SHQIPËRI  
PËRMES PËRMIRËSIMIT TË  
KUADRIT LIGJOR EKZISTUES**

**Autore:** Irida Nasufi, Dorentina Hysa

**Editoi:** Irena Topalli, Ana Mullanji



Ky botim u realizua nga **Organizata Përtej Barrierave** dhe **Qendra "Progres dhe Zhvillim"** në kuadër të projektit strategjik **"Vullnetarizmi PikëAL"**, mbështetur nga **"LëvizAlbania"**, projekti i **Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC**.

Mendimet dhe opinionet e shprehura në të u përkasin autorëve realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



# I. QËLLIMI

Të krijohet një mjedis që mundëson vullnetarizmin e qëndrueshëm në nivel kombëtar, duke përmirësuar kuadrin ligjor ekzistues.

## Problemi

“Ligji Nr. 45 Për Vullnetarizmin” i miratuar në vitin 2016, krijoi barriera duke e paralizuar vullnetarizmin dhe aktivitetin e organizatave të shoqërisë civile që punojnë në këtë fushë, të cilat janë dhe përdoruesi më i madh i shërbimit vullnetar në vend. Qëllimi i ligjit është “nxitja dhe rregullimi i vullnetarizmit”, por në praktikë efekti është i kundërt. Ligji ekzistues nuk i përgjigjet nevojave që kanë vullnetarët, ofruesit dhe përfituesit e shërbimit vullnetar në Shqipëri dhe më tej krijon barriera të konsiderueshme. Është e domosdoshme që të bëhen ndryshime përkatëse, për të krijuar një mjedis legjislativ mundësues që nxit vullnetarizmin në të gjitha format e tij.



# MESAZHET KRYESORE DHE REKOMANDIMET



## REKOMANDIMI 1

Ndryshimi i kuadrit ligjor për rregullimin e vullnetarizmit në Shqipëri, më specifikisht Ligjit Nr. 45/2016, nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore për ato dispozita që janë problematike, dhe miratimi i një pakete që adreson në mënyrë të përshtatshme nevojat e ofruesve dhe përfituesve të vullnetarizmit duke siguruar mbështetje dhe qëndrueshmëri.



## REKOMANDIMI 2

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, si edhe Agjencinë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësi, të fillojnë procesin për përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues, duke përfshirë në konsultime organizatat e shoqërisë civile, ofrues dhe përfitues të shërbimit vullnetar, vullnetarë dhe insitucionet publike.



## REKOMANDIMI 3

Organizatat e shoqërisë civile, ofruese dhe përfituese të shërbimit vullnetar, të konsiderohen si aktorë kyç nga insitucionet qendrore, vendore dhe arsimore, duke vlerësuar ekspertizën disa vjeçare në fushën e vullnetarizmit, gjë e cila do të ndihmonte për të krijuar një mjedis që orientohet nga interesi për vullnetarizëm të qëndrueshëm, cilësor dhe të organizuar.



## II. SITUATA AKTUALE

Në Shqipëri fillimet e rregullimit të vullnetarizmit lidhen me miratimin e [Ligjit 45/2016 “Për Vullnetarizmin”](#), i cili synon të përcaktojë parimet kryesore, kushtet dhe kriteret për kryerjen e vullnetarizmit. Ligji tentoi të bëhej më i aplikueshëm dhe i zbatueshëm vetëm pas miratimit të akteve nënligjore, që përfshinin [Kodin e Etikës](#), [Regjistrin e Vullnetarëve](#) dhe [Librezën e Vullnetarëve](#). Këto akte nënligjore u aprovuan në vitin 2018 dhe 2019, por prej tyre, vetëm Kodi i Etikës së Vullnetarit u bë publik. Sot, pas pesë vitesh nga miratimi i ligjit për vullnetarizmin gjendemi në situatën që ky ligj ka problematika me njohjen, kuptimin dhe zbatimin e tij, si nga organizatat e shoqërisë civile, po ashtu edhe nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e tij.

Problematika kryesore e këtij ligji, fillon që në konceptimin e tij, pasi **nuk është konsultuar me organizatat me eksperiencë dhe ekspertizë në fushën e vullnetarizmit**, që preken drejtëpërdrejtë nga ky ligj. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me aktet nënligjore të dala në vitin 2018 dhe 2019. Mungesa e konsultimit me këtë target grup kryesor çoi në krijimin e një ligji kufizues dhe me efekt negativ që nuk i përgjigjet nevojave të tyre dhe për rrjedhojë nuk gjen zbatim. Qeveria shqiptare, si pjesë të angazhimit për nxitjen e bashkëpunimit dhe përfshirjes së shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse, në vitin 2015 ngriti [Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile](#). Një nga detyrat e këtij këshilli është edhe “këshillimi i Këshillit të Ministrave për përmirësime legislative që ndikojnë në zhvillimin e shoqërisë civile”, që dukshëm nuk është përmbushur në praktikë.



Organizatat e shoqërisë civile kanë reaguuar dhe ngritur zërin fill pas miratimit të këtij ligji, duke kërkuar më shumë informacion, kanë dërguar letra, emaile, ankesa dhe rekomandime lidhur me problematikat e Ligjit për Vullnetarizmin. [Qendra Burimore për Shoqërinë Civile](#) në bashkëpunim me [Organizatën Përtej Barrierave](#), kanë organizuar një sëri takimesh me organizatat e shoqërisë civile në të gjithë vendin, tryeza informimi dhe kërkime që kanë pasur në fokus vullnetarizmin dhe rregullimin e tij me këtë ligj. Nga studimi i Organizatës Përtej Barrierave publikuar përmes projektit [ROUTE WB6, "Infrastruktura e vullnetarizmit në Shqipëri- Status quo dhe zhvillimet"](#) rezulton se organizatat pjesëmarrëse në studim, të cilat angazhojnë vullnetarë në përditshmërinë e tyre, të ndikuara nga miratimi i Ligjit kanë ndaluar ushtrimin e veprimtarisë së përfshirjes së vullnetarëve për rreth 4 vite. Ndikim ky që bie ndesh me qëllimin që Ligji synon të arrijë, *"rritjen e angazhimit qytetar të pjesëmarrjes së individëve në jetën sociale për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet, si dhe zhvillimin e vlerave të solidaritetit njerëzor."*

Parimisht, rregullimi nga njëra anë është krejtësisht i domosdoshëm në njohjen dhe krijimin e mjedisit mundësues të vullnetarizmit, por nga ana tjetër, ligji në fjalë mbart shumë problematika në tërësinë e tij, që krijojnë barriera shtesë për ofruesit dhe marrësit e shërbimit vullnetar. Mbështetur në shqetësimet e organizatave të shoqërisë civile, si edhe nevojës për të krijuar mjedisin mundësues për nxitjen dhe promovimin e vullnetarizmit, është thelbësore që të ndërmerren masat e nevojshme për të rregulluar fillimisht kuadrin ligjor ekzistues, i cili përbën pengesën më të madhe në këtë drejtim.





Për t'iu përgjigjur këtyre nevojave, projekti **[“Vullnetarizmi PikëA1”](#)** i zbatuar nga **Organizata Përtej Barrierave, Projekte Vullnetare Ndërkombëtare dhe Qendra Progres dhe Zhvillim**, mbështetur nga grantet strategjike të **[Lëviz Albania](#)**, synon të kontribuojë në krijimin e një mjedisi mundësues shumë dimensional ku vullnetarizmi inkurajohet, mbështetet, njihet si mekanizëm kyç për nxitjen e qytetarisë aktive, solidaritetit dhe kohezionit social në Shqipëri. Projekti synon të përmirësojë infrastrukturën ekzistente ligjore dhe sociale me ndërhyrje sistemike nga poshtë-lart dhe propozon një sistem funksional me qasje inovative dhe impakt të drejtëpërdrejtë për vullnetarizëm gjithëpërfshirës, cilësor dhe me standarde për të gjithë aktorët e interesuar. Ky dokument politik është hartuar në kuadër të këtij projekti.



### III. PROBLEMATIKAT E KUADRIT LIGJOR EKZISTUES

Në vitin 2020 Qendra Burimore për Shoqërinë Civile në bashkëpunim me ekspertin ligjor, znj. Ardjana Shehi publikuan [Opinionin ligjor “Mbi kuadrin ligjor për Vullnetarizmin dhe zbatueshmërinë e tij”](#).

Bazuar në këtë analizë, rezulton se ligji është i paqartë në pjesën më të madhe të tij dhe kjo sjell pasoja në zbatimin e tij në praktikë. **Kuadri ligjor ekzistues nuk është i plotë dhe mundësues për organizatat e shoqërisë civile që punojnë me vullnetarë dhe programe vullnetarizmi, duke u ndeshur me vështirësi dhe paqartësi për përfshirjen e vullnetarëve në projektet dhe aktivitetet e tyre dhe duke i ekspozuar ata ndaj riskut të gjobave.**

Pika specifike që janë problematike dhe të pasqaruara në ligj lidhen, së pari, me ofruesin e vullnetarizmit (**Neni 9**) ku përveç organizatave të shoqërisë civile përfshihen edhe personat juridik. Shqetësimi kryesor lidhur me këtë pikë është krijimi i një paqartësie mes shoqërive tregtare dhe organizatave jofitimprurëse, duke krijuar më tej edhe problematika në trajtimin fiskal të tyre. Është e rëndësishme së pari, sqarimi i vullnetarizmit nga ana e shoqërisë tregtare, pasi qartazi nuk mund të trajtohen njësoj me organizatat e shoqërisë civile.

Së dyti, **marrëdhënia e vullnetarizmit**, ku në ligjin në fjalë synohet të dallohet shërbimi vullnetar nga marrëdhënia e punës apo e shërbimit, megjithëse dispozitat përkatëse nuk janë të qarta dhe nuk arrihet të identifikohet çfarë marrëdhënie e veçantë ligjore apo kontraktore krijohet midis Vullnetarit dhe Ofruesit të Vullnetarizimit.



Së treti, ligji parashikon **kontratën e vullnetarizmit** si një formë të veçantë, por lidhur me këtë pikë problematike paraqiten kushtet e pavlefshmërisë së kontratës së vullnetarizmit, natyrën e kontratës së vullnetarit, si edhe sigurimet që duhen paguar për vullnetarin. Ligji në nenin 16 të tij, thekson se *“kontratat e vullnetarizmit, që lidhen me qëllim shmangien e lidhjes së një kontrate pune, janë të pavlefshme”*. Në këto rrethana, ekziston rreziku që inspektoriat i ngarkuar nga ligji për të bërë shqyrtimin e zbatimit të ligjit, mund ta trajtojë atë si një kontratë pune dhe organizatat e shoqërisë civile vihen në shënjestër të detyrimeve përkatëse. Rekomandohet që kjo dispozitë të rishikohet dhe qartësohet në ligj.

Së katërti, **ligji prek edhe çështjen e sigurimit të vullnetarëve**, që sërish është një pikë e paqartë. Në nenin 22 theksohet detyrimi i ofruesit të vullnetarizmit për të siguruar vullnetarin në rast të aksidenteve apo sëmundjeve që ndodhin gjatë kohëzgjatjes së kontratës së vullnetarizmit, ndërkohë në pikën 2 të këtij neni shprehimisht thuhet se *“ofruesi i vullnetarizmit është i detyruar t'i japë vullnetarit një kopje të kontratës së sigurimit të shëndetit dhe aksidenteve, brenda 3 ditëve nga firmosja e kontratës së vullnetarizmit”*. Është e rëndësishme që këto dy pika të ligjit të shqyrtohen për t'u sqaruar më tej, pasi ligjërisht “sigurimi i vullnetarit në raste sëmundjesh dhe aksidentesh” dhe “kontrata e sigurimit të shëndetit dhe aksidenteve” janë koncepte të ndryshme që duhen reflektuar qartazi në ligj për të mos krijuar hapësira për abuzime dhe situata të pazgjdhshme, që veçanërisht bien në kurriz të organizatave të shoqërisë civile, ofruese të vullnetarizmit.



Ky qëllim duhet të përcaktohet shprehimisht në ligj dhe Regjistri duhet të përdoret vetëm për qëllime të vlerësimit të punës vullnetare të individëve përkatës, duke qenë kështu në përputhje me qëllimin e Ligjit nr.45/2016 të përcaktuar në nenin 2 të tij. Duhet qartësuar që në asnjë rrethanë ky regjistër nuk do të përdoret si mjet evidentimi dhe burim prove për të ngarkuar me detyrime financiare dhe fiskale, apo kontribute, organizatat Ofruese të Vullnetarizimit.

**Së pesti, ligji në fjalë trajton në të njëjtën mënyrë, si vullnetarizmin e strukturuar afatgjatë ashtu dhe atë sporadik apo afatshkurtër, duke sjellë kështu një barrë të madhe administrative për ofruesit e vullnetarizmit afatshkurtër. Një ofrues i vullnetarizmit afatshkurtër, i cili kërkon të organizojë një aksion pastrimi 1 ditor apo një event të madh sportiv si maratonat, evente këto që kërkojnë angazhimin e një numri të madh vullnetarësh, nuk mund të trajtohen njëjloj me vullnetarizmin disa mujor. Në një rast të tillë ofruesit të vullnetarizmit i bie barra e komunikimit, rekrutimit, orientimit, trajnimit dhe kontraktimit të një numri të madh vullnetarësh, gjë e cila mund të shkojë përtej kapaciteteve të OSHC-ve dhe demotivn ofruesit e vullnetarizmit që të zbatojnë nisma të tilla.**

Për ta përmbledhur, ligji synon të rregullojë angazhimin si vullnetar, megjithëse ky angazhim është me vullnet të lirë të gjithësecilit dhe si i tillë nuk duhet cënuar me kuadër ligjor pengues dhe kufizues. **Ligji aktual nuk shërben as për ta rregulluar dhe as për të nxitur vullnetarizmin, por përkundrazi e ka tkurrur edhe në ato sektorë që ka qenë ekzistues.** Mungesa e një pakete fiskale për këtë ligj dukshëm ka penguar gjithashtu zbatimin e mirëfilltë dhe zhvillimin e fushës së vullnetarizmit në vend.



Problematikat që krijon ligji duhen marrë në shqyrtim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile dhe palë të tjera të përfshira në një mënyrë a në një tjetër në zbatimin e këtij ligji.



# IV. STUDIMI KOMBËTAR MBI VULLNETARIZMIN NË SHQIPËRI

## Metodologjia

Për të mbledhur të dhëna empirike lidhur me situatën e vullnetarizmit në Shqipëri në fillim të vitit 2021 u realizua studimi kombëtar [“Vullnetarizmi në Shqipëri”](#). Studimi u mbështet në të dhëna të grumbulluara në 12 qarqet e Shqipërisë, ku morën pjesë në total 1236 qytetarë të moshës 15- 65 vjeç, prej të cilëve 1104 të anketuar; 115 pjesëmarrës në 16 fokus grupe nga sektori i ofruesve të vullnetarizmit dhe 17 intervistave të strukturuar me institucionet qendrore, vendore dhe shoqëria civile.

Metodologjia e studimit ishte e kombinuar, sasimore dhe cilësore. Për realizimin e këtij studimi u hartuan 3 instrumente bazë për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave: intervistat e thelluara me institucionet qendrore, të cilat kanë rol në hartimin e politikave, ngritjen e mekanizmave etj; fokus grupet, aktorë kyç në ofrimin dhe nxitjen e vullnetarizmit si: institucione vendore, organizata të shoqërisë civile, media, institucionet arsimore dhe shëndetësore, (instrumentet cilësore); dhe pyetësori gjysmë i strukturuar për qytetarët mbi 15 vjeç (instrumenti sasior).

Të dhënat cilësore të regjistruara në audio dhe të transkriptuara u analizuan duke përdorur metodën e analizës së përmbajtjes, ndërsa të dhënat e mbledhura u përpunuan nga ana statistikore me paketën statistikore SPSS. Analiza univariate dhe bivariate u krye për të përshkruar dhe shqyrtuar marrëdhëniet mes karakteristikave të



anketuarve në nivel individual. Analiza përfshiu, gjithashtu, një rishikim të kuadrit institucional dhe rregullator. U mbledhën dhe shqyrtuan gjithë dokumentet dhe raportet relevante të prodhuar ndër vite nga organizatat ndërkombëtare, organizatat lokale, organet qeveritare dhe studimet akademike të cilat i referohen punës vullnetare në Shqipëri.

## Gjetjet e studimit

Disa nga gjetjet kryesore të studimit, që janë relevante për këtë dokument janë si vijon:

- **77% e pjesëmarrësve në studim besojnë se kontributi vullnetar në Shqipëri është shumë i nevojshëm. 90%, shprehen se nuk kanë informacion se ku dhe si mund të japin kontributin e tyre vullnetar.**
- Pjesa më e madhe e të anketuarve **87%, nuk janë në dijeni të librezës së vullnetarit**, dhe një pjesë e konsiderueshme **2/3 nuk kanë informacion as për Ligjin mbi Vullnetarizmin**. Rreth **80%** e ofruesve të vullnetarizmit **nuk kanë informacion rreth Ligjit**.
- Për personat që nuk kanë pasur eksperiencë vullnetare, disa nga arsyet më të shpeshta për mungesën e kësaj përvojë janë: **mungesa e rregulloreve mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e vullnetarëve (67%); mosnjohja dhe mosvlerësimi i kontributit vullnetar në Shqipëri (47%); mungesa e njohurive (45%); mosorientimi apo kërkesa (42%); pakënaqësia me organizimin.**



- Praktikrat e menaxhimit dhe organizimit të vullnetarizmit nga institucione të ndryshme tregojnë se **vullnetarizmi shihet si një aktivitet i cili nuk është i mirëorganizuar apo i strukturuar** sipas një modeli të caktuar.
- Sfidat kryesore me të cilat institucionet përballen janë: **skepticizmi ndaj konceptit të vullnetarizmit, mungesa e kapaciteteve të organizatave për t'i mbajtur vullnetarët dhe për të krijuar sisteme të qëndrueshme të vullnetarizmit, në aspektin e promovimit dhe rritjes profesionale të individëve, mungesa e informacionit dhe ndërgjegjësimi i ulët mbi mundësitë e vullnetarizmit, koordinim jo fort i mirë me operatorët privatë apo bizneset për të përfshirë vullnetarët. Infrastruktura jo e duhur ligjore, strukturore dhe burokracia e institucioneve bëhet shpeshherë pengesë për organizatat joqeveritare, të cilat konstatojnë se ekziston në përgjithësi një klimë jofavorizuese dhe burokratike në lidhje me procedurat që duhet të ndiqen apo edhe me mungesë informacioni. Institucionet përgjegjëse për monitorimin e punës vullnetare, siç është Shërbimi Kombëtar i Punësimit/Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive nuk i ka kapacitetet e duhura njerëzore dhe teknike për të monitoruar vullnetarizmin në terren.**
- Miratimi i Ligjit të Vullnetarizmit vlerësohet si një nismë e mirë, që duhet të ndihmonte dhe zhvillonte këtë sektor, por mënyra se si ligji u përgatit, mënyra se si u miratua dhe më pas zbatimi efektiv i ligjit në praktikë përballlet me shumë sfida, dhe shpeshherë është një pengesë për nxitjen e vullnetarizmit në vend. Një pjesë e përfaqësuesëve nga OSHC-të shprehen se pagesa e siguracioneve të vullnetarëve është një kosto tepër e lartë për t'u përballuar nga





- ata vetë dhe, për rrjedhojë, nuk i kanë ndjekur procedurat e regjistrimit të vullnetarëve. Pra, sfida kryesore mbetet krijimi i një strukture të qartë dhe të qëndrueshme që rekruton, orienton dhe menaxhon vullnetarët.
- Pjesëmarrësit në fokus grupe shprehen se një platformë kombëtare për menaxhimin dhe organizimin e praktikave vullnetare do të ishte një mjet efikas me shumë përfitime për vetë vullnetarët, por edhe për OSHC-të apo institucione të tjera që kanë nevojë për të rekrutuar vullnetarë.
- 27.9 % e pjesëmarrësve mendojnë se rol kyç në nxitjen e vullnetarizmit luajnë vetë individët, ndërsa 22.6 % mendojnë se janë organizatat e shoqërisë civile që duhet ta nxisin dhe 22.5 % mendon se është pushteti vendor nxitësi. Si aktorë të tjerë renditet pushtetit qendror me 15.4% dhe media me 11.6 %.



## V. KONFERENCA KOMBËTARE E VULLNETARIZMIT

Në Maj 2021 u mbajt Konferenca e parë Kombëtare e Vullnetarizmit 1.0, që kishte si qëllim të sillte të gjithë aktorët kyc në një tryezë për të krijuar një platformë kombëtare diskutimi dhe konsultimi mbi vullnetarizmin. Konferenca është përpjekje për të nxitur bashkëpunimin ndërsektorial, përmirësimin e terrenit ligjor dhe social të vullnetarizmit në vend dhe të nxisë frymën e bashkëpunimit mes sektorit të ofruesve të vullnetarizmit. Në konferencë morën pjesë mbi 100 pjesëmarrës, përfshirë këtu përfaqësues të institucioneve publike qendore dhe vendore, përfaqësues të shoqërisë civile, organizatata ndërkombëtare, menaxherë projektsh, vullnetarë, mësues dhe pedagogë, të rinj, nxënës dhe studentë, qytetarë, ekspertë të fushave të lidhura drejtëpërdrejtë me vullnetarizmin. Gjatë konferencës u bë e mundur mbledhja e rekomandimeve kryesore të pjesëmarrësve, në tre aspekte kyçe që ndikojnë vullnetarizmin në Shqipëri.

**Lidhur me përmirësimin e infrastrukturës Ligjore dhe Institucionale të Vullnetarizmit në Shqipëri dhe bashkëpunimit ndërsektorial për vullnetarizëm të qëndrueshëm dhe të strukturuar, rekomandohet:**

- Të reflektohen ndryshimet ligjore në bashkëpunim të fortë mes institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë vendorë.
- Të promovohet vullnetarizmi dhe praktikat më të mira, si nga OSHC-të, ashtu edhe nga institucionet shtetërore, po ashtu edhe të njihet kontributi vullnetar si përvojë.



- Të promovohet vullnetarizmi dhe praktikat më të mira, si nga OSHC-të, ashtu edhe nga institucionet shtetërore, po ashtu edhe të njihet kontributi vullnetar si përvojë.
- Të informohen dhe edukohen institucionet dhe të rriten kapacitetet e stafeve të tyre lidhur me shërbimet vullnetare.
- Të realizohen studime të mëtejshme në fushën e vullnetarizmit, në mënyrë që vendimmarrja, politikat dhe kuadri rregullues të jenë të mbështetura në evidenca dhe në përputhje me situatën e vendit tonë.
- Të rritet cilësia e menaxhimit dhe ofrimit të shërbimeve vullnetare, përfshirë këtu edhe hartimin e një marrëveshjeje përsa i përket të drejtave dhe përgjegjësisë si të institucioneve shtetërore, të organizatave të shoqërisë civile, dhe të vullnetarëve. Kjo bën të mundur që të dyja palët të njohin pritshmëritë e tyre të dyanshme.
- Të krijohet një protokoll me standarde specifike i cili tu vijë në ndihmë ofruesve të vullnetarizmit për të ngritur dhe mirë menaxhuar sisteme të qëndrueshme të angazhimit të vullnetarëve.
- Të merren masa për krijimin e një pakete fiskale apo skeme financimi të qëdrueshme për ligjin specifik. Kjo do të krijonte qëndrueshmëri dhe rritje të cilësisë së punës për ofruesit e vullnetarizmit dhe do të nxiste përfshirjen më të madhe të vetë vullnetarëve.
- Të punohet me të gjitha institucionet dhe OSHC-të, në promovimin e shërbimit dhe angazhimit vullnetar. Njohja dhe vlerësimi i eksperiencës vullnetare nga institucionet do të sillte zhvillime pozitive në shoqëri.



Sa i përket kapacitetet e munguara të **organizatave të shoqërisë civile**, rekomandimet janë:

- Të zgjerohet arritja e OSHC-ve edhe në ato zona që nuk kanë akses as në informacion, e as në shërbime, për të arrirë kështu personat me më pak mundësi dhe të disavantazuar, kryesisht në zonat rurale, por edhe në qytetet e vogla.
- Të promovojnë vullnetarizmin përmes vlerave, përfitimeve dhe detyrimeve që sjell dhe jo thjesht si një mekanizëm drejt tregut të punës/punësimit.
- Të jenë më proaktive në bashkëpunimin me organizatat e tjera të Shoqërisë Civile dhe njësisive të qeverisjes vendore apo gjithë mekanizmave të tjerë.
- Të promovojnë vullnetarizmit në shkolla, duke i edukuar fëmijët me vlerat dhe parimet e vullnetarizmit, si edhe të promovojnë shembujt apo praktikat më të mira në median tradicionale apo median sociale.
- Të rrisin kapacitetet e stafeve të tyre duke i trajnuar dhe asistuar at anë rritjen profesionale në mënyrë që të mund të zbatojnë projekte dhe programe vullnetare cilësore.

Rekomadimet për **ndërgjegjësimin mbi vullnetarizmin në Shqipëri**, janë:

- Të nxitet bashkëpunimi ndërsektorial, mes OSHC-ve dhe institucioneve qendrore dhe vendore në mënyrë që të strukturohet dhe menaxhohet vullnetarizmi në Shqipëri.



- Të rritet ndërgjegjësimi duke përdorur dixhitalizimin; shpërndarjen e informacionit dhe organizimin e sesioneve informuese në bashkëpunim me aktorë të tjerë.
- Të nxitet vullnetarizmi ndër të rinjtë veçanërisht nëpërmjet edukimit për vlerën e vullnetarizmit dhe programeve nxitëse në bashkëpunim me shkollat, universitetet dhe më gjerë.
- Të realizohen fushata ndërgjegjësimi për problematika aktuale që hasen, të cilat vullnetarizmi mund t'i ndihmojë për t'i zgjidhur.
- Të theksohet vlera e solidaritetit që vullnetarizmi sjell në komunitete, si një aspekt thelbësor i kontributit që shërbimi vullnetar i ofron shoqërisë.



## VI. REKOMANDIMET

### ◦ Rekomandimi 1 ◦

Ndryshimi i kuadrit ligjor për rregullimin e vullnetarizmit në Shqipëri, më specifikisht Ligjit Nr. 45/2016, nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore për ato dispozita që janë problematike, dhe miratimi i një pakete financiare që adreson në mënyrë të përshtatshme nevojat e ofruesve dhe përfituesve të vullnetarizmit duke siguruar mbështetje dhe qëndrueshmëri.

### ◦ Rekomandimi 2 ◦

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, si edhe Agjencinë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësi, të fillojnë procesin për përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues, duke përfshirë në konsultime me organizata të shoqërisë civile, ofrues dhe përfitues të shërbimit vullnetar, vullnetarë dhe insitucionet publike.

### ◦ Rekomandimi 3 ◦

Organizatat e shoqërisë civile, ofruese dhe përfituese të shërbimit vullnetar, të konsiderohen si aktorë kyc nga insitucionet qendrore, vendore dhe arsimore, duke vlerësuar ekspertizën disa vjecare në fushën e vullnetarizmit, gjë e cila do të ndihmonte për të krijuar një mjedis që orientohet nga interesi për vullnetarizëm të qëndrueshëm, cilësor dhe të organizuar.




## VII. REFERENCA

- Rama, O., Xhaho, Armela (2021). Vullnetarizmi në Shqipëri. Studim Kombëtar. Projekte Vullnetare Ndërkombëtare. I aksesueshëm në: [Vullnetarizmi ne Shqiperi Studimi Kombetar](#)
- Topalli, I (2020). Volunteer Infrastructure in Albania. Status quo and developments. Beyond Barriers Associations. I aksesueshëm në: [Volunteering Infrastructure in Albania-Status Quo and Developments](#)
- Deklaratë Publike e Grupimit (2021). Mbi Vullnetarizmin dhe Zhvillimin e tij në Shqipëri. Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile. I aksesueshëm në: [Mbi Vullnetarizmin AL](#)
- Shehi, A. (2020). Opinion Ligjor: Mbi kuadrin ligjor për vullnetarizmin dhe zbatueshmërinë e tij. Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë civile. I aksesueshëm në: [Opinion Ligjor mbi Ligjin e Vullnetarizmit 2021](#)
- Ligji Nr.45/2016 “Për Vullnetarizmin”. I aksesueshëm në: [Ligji “Për Vullnetarizmin”](#)
- Ligji Nr. 119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e këshillit kombëtar për shoqërinë civile”. I aksesueshëm në: [Nr. 119/2015,per KKSHC](#)
- Vendim Nr. 506, datë 17.07.2019 “Për miratimin e Kodit të etikës së vullnetarit”. I aksesueshëm në: [Për miratimin e Kodit të etikës së vullnetarit](#)








**PERTEJ BARRIERAVE**  
Ne besojmë në atë që bëjmë



Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për  
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC